Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti të mbledhjes së 265-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 266, 267 dhe 278 Elektronike\Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh. A.), zonat kadastrale: Siboc, Shipitullë, Leshkoshiq, Hade dhe Palaj, Komuna Obiliq, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh. A.).

5. Kompensimi i pronave të pronarëve që shpronësohen, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe të vlerësimit, si dhe të gjitha obligimet e tjera që mund të rrjedhin nga proceset administrative dhe gjyqësore, do të bëhen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh. A.), nga buxheti i saj.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish-shoqërore, që administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zona Kadastrale Beroc II, Komuna Shtërpcë, për nevoja të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovë, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe të obligimeve të tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, që menaxhohen dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e projektit "Ndërtimi i Qendrës për Sport dhe Kulturë në Komunën e Ferizajt", Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe të obligimeve të tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Gjakovës:

   - Ndërtimi i Fushës së Futbollit në Lagjen "Dardania", Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës;
   - Administrimi i objektit të ish-"Bankos"-it për nevoja të administratës së Komunës së Gjakovës, Zona Kadastrale, Gjakovë - Qytet, Komuna e Gjakovës; dhe
   - Ndërtimi i Fushës së Futbollit dhe hapësirave rekreative për fshatin Trakaniq dhe fshatrat rreth zonës Trakaniq, Zona Kadastrale Trakaniq.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit, do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Komuna e Gjakovës.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Gjakovës.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish-shoqërore KBI "Progres", që menaxhohet dhe administrohet nga AKP-ja, shpronësimi i së cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit "Objekte Edukativo-Arsimore dhe Sportive", Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna Prizren, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit, do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Komuna e Prizrenit.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Prizrenit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore të N. Sh. Industria e Mobilieve "Përparimi" dhe atyre private për nevoja të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe të obligimeve të tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 3, 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës të Subjektit Kërkues/Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Linja ajrore 110kV, Parku me Erë-Zatriqi 1&2", zonat kadastrale: Rahovec, Zatriq dhe Drenoc, Komuna Rahovec, investim nga kompania "EV WIND PARK Sh.P.K.", sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit do të bëhen nga Investitori "EV-WIND PARK Sh.P.K.".

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.) dhe Investitori "EV-WIND PARK Sh.P.K.".

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministravc)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore për nevoja të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA), Zona Kadastrale Vrellë e Goleshit dhe Mirenë, Komuna e Lipjanit, Zona Kadastrale Zatriq, Komuna e Rahovecit; Zona Kadastrale Mramor, Komuna e Prishtinës dhe Zona Kadastrale Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit, do të bëhen nga buxheti i Subjektit Kërkues/ Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: Rehabilitimi, Zgjerimi dhe Asfaltimi i Rrugës Nacionale R118, segmenti brenda fshatit Mushtisht, Zona Kadastrale Mushtisht, Komuna e Suharekës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Vlerësimi i pronave të paluajtshme do të bëhet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministravc)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi Rrugës Korishë – Kabash – Lidhja me Rrugën Rajonale R-118, zonat kadastrale Lubizhdë, Skorobishtë, Korishë, Kabash, Komuna e Prizrenit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Vlerësimi i pronave të paluajtshme do të bëhet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Ndërtesave të Banimit të Përballueshëm dhe Social" për Komunën e Podujevës, Zona Kadastrale Podujevë, Komuna Podujevë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi, në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit ne pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike, pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues - Komuna e Podujevës do ta paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit, i cili është pjesë e këtij Vendimi, konform legjislacionit në fuqi.

8. Subjekti Kërkues - Komuna e Podujevës do t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare, që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit, dhe vendimet gjyqësore.

9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.

10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: "FLLOWS" i financuar nga Banka Botërore dhe Ndërmarrja Rajonale për Ujësjellës "Hidromorava" Sh. A. Zona Kadastrale Perlepnicë, Komuna e Gjilanit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi, në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar, i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike ka të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues - "Hidromorava" do ta paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit, i cili është pjesë e këtij Vendimi, konform legjislacionit në fuqi.

8. Subjekti Kërkues - "Hidromorava" do t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare, që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit, dhe vendimet gjyqësore.

9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.

10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R-118 Mushtisht - Shtërpcë, zonat kadastrale Delloc, Komuna e Suharekës dhe Vërbeshticë, Komuna Shtërpcë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit, të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do ta paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në raportet e vlerësimit konform legjislacionit në fuqi.

8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Qarkores së Jashtme të Qytetit të Gjilanit dhe Kyçja e Rrugës Nacionale N25.2 dhe N25.3 deri te Autoudha R7.1", zonat kadastrale Velekincë, Gjilan, Livoç i Ulët, Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit, të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do ta paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit, konform legjislacionit në fuqi.

8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Qarkorja e Vjetër e Qytetit të Gjilanit, Llot 1 dhe Llot 2", zonat kadastrale: Shillovë, Livoç i Ulët dhe Gjilan, Komuna e Gjilanit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilësdo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për transferimin e mjeteve buxhetore, në shumë prej 2.041.000€ (dy milionë e dyzetenjë mijë eurosh) deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2025, për subvencionimin e blerjes së teksteve dhe materialeve mësimore, për vitin shkollor 2025/2026.

2. Mjetet buxhetore, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me kod 208, nga nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:

   2.1. Administrata Qendrore, me kod 11308, merret shuma prej 1.500.000€ (një milion e pesëqind mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24,25%;
   2.2. Arsimi Profesional, me kod 92500, merret shuma prej 37.000€ (tridhjeteshtatë mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24,67%;
   2.3. Trajnimi i Mësuesve, me kod 91000, merret shuma prej 90.000€ (nëntëdhjetë mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24,83%;
   2.4. Zhvillimi i Planprogramit, me kod 91100, merret shuma prej 45.000€ (dyzetepesë mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24,19%;
   2.5. Marrëveshja Bilaterale, me kod 91700, merret shuma prej 270.000€ (dyqind e shtatëdhjetë mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24,55%;
   2.6. Arsimi Profesional, me kod 92500, merret shuma prej 20.000€ (njëzet mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -19,53%;
   2.7. Inspektorati i Arsimit të Kosovës, me kod 98000, merret shuma prej 79.000€ (shtatëdhjetenëntë mijë eurosh) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24,94%.

3. Mjetet buxhetore, sipas pikës 2. të këtij Vendimi, në shumë prej 2.041.000€ (dy milionë e dyzetenjë mijë eurosh), deri nga nënprogramet e lartcekura, transferohen në nënprogramin "Investimet kapitale në Arsimin Parauniversitar", me kod 98100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".

4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, plotësohet si në vijim:

   Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:

   1.1 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, e amendamentuar dhe e zgjeruar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/1842 (28.06.2024), Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/3189 (16.12.2024), si dhe Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/3183 (16.12.2024); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/3192 (16.12.2024); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2024/2642, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/3188 (16.12.2024); respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP (16.12.2024), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2024/3182 (16.12.2024) si dhe Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (16.12.2024), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2024/3187 (16.12.2024).

   1.2 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/390 (24.02.2025) dhe Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/389 (24.02.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/395 (24.02.2025); Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 765/2006, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/392 (24.02.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2022/263, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/398 (24.02.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 692/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/401 (24.02.2025); respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP (24.02.2025), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/388 (24.02.2025); Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (24.02.2025), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/391 (24.02.2025); Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (24.02.2025), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/394 (24.02.2025); Vendimit të Këshillit 2022/266/CFSP (24.02.2025), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/396 (24.02.2025); si

dhe Vendimit të Këshillit 2014/386/CFSP (24.02.2025), i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/397 (24.02.2025).

1.3 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/932 (20.05.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2024/2642, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/964 (20.05.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/933 (20.05.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2024/1485, e zbatuar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/958 (20.05.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2018/1542, e zbatuar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/959 (20.05.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2024/2642, e zbatuar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/965 (20.05.2025) dhe Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/968 (20.05.2025); respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP, i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/931 (20.05.2025), si dhe Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, i amenduar me Vendimin (CFSP) 2025/936 (20.05.2025).

1.4 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, e zbatuar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/1476 (18.07.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014, e amenduar dhe e zgjeruar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/1494 (18.07.2025); Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 765/2006, e zbatuar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2025/1469 (18.07.2025) dhe e amenduar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2025/1472 (18.07.2025).

2. Të gjitha llojet e sanksioneve, si dhe emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të përmendura në pikën 1., konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Masat shtrënguese/kufizuese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, të plotësohen apo të ndryshohen.

4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2022 për Komisionin e Ankesave për të Huajt, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Ankesave për të Huajt në këtë përbërje:

   1.1. Qëndrim Bytyqi, Ministria e Punëve të Brendshme, kryesues;
   1.2. Arsim Beqiri, Ministria e Drejtësisë, zv. kryesues;
   1.3. Arben Muhameti, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
   1.4. Era Hasani, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtare; dhe
   1.5. Qlirim Ahma, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar.

2. Mandati i Komisionit është tri (3) vjet dhe është i pavarur gjatë punës së tij.

3. DShAM/MPB luan rolin e Sekretarisë së Komisionit dhe të njëjtit i ofrojnë kushte teknike për ushtrimin e përgjegjësisë.

4. Komisioni gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive e zbaton Ligjin në fuqi për të Huajt dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Ligjin në fuqi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe legjislacionin tjetër, i cili është relevant në ushtrimin e përgjegjësive të Komisionit.

5. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e përmendura në pikën 1. të këtij Vendimi për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 13/96, i datës 14 shtator 2022.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 paragrafit 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178 të datës 13.12.2022, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178 të datës 13.12.2023, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241 të datës 27.12.2024, si dhe në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 3,000,000.00€ (tre milionë eurosh), për zbatimin e masës 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet e ndara, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, në nënprogramin "Rehabilitimi i Rrugëve", me kod 41800, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale" me kod 15039.

3. Mjetet, sipas këtij Vendimi, transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në nënprogramin përkatës.

4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 1.7, dhe nenit 15, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet bartja mjeteve të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025 të fondeve nga nënprogrami "Kontigjenca për Energji", në shumë prej 904,265.48 € (nëntëqindekatër mijë e dyqind e gjashtëdhjetepesë euro e dyzetetetë centë).

2. Mjetet, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, barten në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Kontigjenca për Energji", me kod 29050, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministravë)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, me Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112, të datës 13.12.2022, i i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 03/128, të datës 16.02.2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore, në shumë prej 904,265.48€ (nëntëqindekatër mijë e dyqind e gjashtëdhjetepesë euro e dyzetetetë centë) për zbatimin e masave 4 dhe 5 të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, në kuadër të Masës 3.7 – Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nënprogrami "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere" dhe transferohen, si në vijim:

   2.1. Në Ministrinë e Ekonomisë, me kod 213, shuma prej 615,879.28€, në nënprogramin "Administrata Qendrore", me kod 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere", për zbatimin e masave 4 dhe 5 të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, në kuadër të Masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

   2.2. Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, shuma prej 288,386.20€, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".

3. Obligohet Thesari që mjetet, sipas pikës 2.2. të këtij Vendimi, t'i transferojë tek organizata jobuxhetore Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë, në llogarinë bankare të përcaktuar nga ta, për zbatimin e mbështetjes buxhetore në kuadër të IPA 2023.

4. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00097) në programin përkatës.

5. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministra e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/269
Datë: 19.09.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 147,300€ (njëqind e dyzet e shtatë mijë e treqindte euro) për mbështetjen e aktiviteteve të rëndësishme që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reputacionin, si në vijim:

2. Për të garantuar vazhdimësinë e platformës më të rëndësishme kombëtare për inovacion dhe zhvillim dixhital, propozohet financimi:

   2.1. KosICT – 37,300€;
   2.2. Doku Tech – 35,600€;
   2.3. Growth Tank – 40,200€;
   2.4. Shfrytëzimi i hapësirës në Tech Park Prishtina – 7,900€.

3. Mbështetje për bujqësi të qëndrueshme dhe avancim shkencor:

   3.1. Konferenca e 10-të Ndërkombëtare për Mjedrën – 26,300€.

4. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogaritë e përcaktuara nga subjektet përfituese.

5. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë